



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	13 - 12 2023	3	viti god year
Organ /Njesia Org./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRMSTOK	7449/2023		116



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1290/2023

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1290/2023 të datës 16.10.2023 të parashtruar nga ankuesja ..... me adresë rruga ..... në Komunën e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike "Transfer", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 12.12.2023, mori këtë:

### V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1290/2023 e datës 16.10.2023 e parashtruar nga ankuesja .....

II. Shfuqizohet Vendimi me Nr.5546/23 i datës 22.09.2023 i Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

III. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke e kthyer ankuesen në pozitën "Udhëheqëse e Divizionit për Menaxhimin e Resurseve Ujore" në Divizionin për Menaxhimin e Resurseve Ujore sipas Ndryshim plotësimit të Akt Emërimit të datës 11.07.2017 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga marrëdhënia e saj e punës.

IV. Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.



## Ar sy et im

Ankuesja e punësuar në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, sipas Ndryshim Plotësimi të Akt emërimit të datës 11.07.2017 në pozitën "Udhëheqëse e Divizionit për Menaxhimin e Resurseve Ujore " në Divizionin për Menaxhimin e Resurseve Ujore.

Me datën 22.09.2023, Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka nxjerrë Vendimin me Nr.5546/23 sipas së cilës ankuesen nga pozita Udhëheqëse e Divizionit për Menaxhimin e Resurseve Ujore, e ka transferuar përkohësisht në pozitën Udhëheqëse e Sektorit të Monitorimit të Cilësisë së Ujërave dhe Dheut në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajsh, bazuar në kërkesën e datës 22.09.2023 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të ministrisë në fjalë.

E pakënaqur me vendimin për transferim nga ana e Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ankuesja me datën 16.10.2023 fizikisht ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 6551/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore kundër Vendimit me Nr.5546/23 të datës 22.09.2023, për shkak të : shkeljes së ligjit material, shkeljeve thelbësore të procedurës dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 23.10.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Ndërsa Këshilli, me datën 30.10.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesën e ankueses së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafit 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me numër protokollit 7101/2023, të datës 27.11.2023, ka vazhduar afatin për vendimmarrje edhe për 10 ditë pune lidhur me ankesën A.nr.1290/2023, të datës 16.10.2023.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin në vijim Kolegji i Këshillit), për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesën e ankueses të datës 16.10.2023 me numër protokollit 6551/2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Raportin mjekësor të ankueses të datës 14.09.2023 nga Klinika Cardio Plus në Prishtinë; Vendimin me Nr.5546/2023 të datës 22.09.2023 të Udhëheqëses të Divizionit të Burimeve Njerëzore; Vendimin me Nr.113/2023 të datës 28.08.2023 nga Agjencia për Informim dhe Privatësi; Aktgjykimin me numër P.nr.1477/3 të datës 14.09.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm; Komunikimet elektronike të datës 18.07.2023, 18.09.2023 ndërmjet ankueses dhe zyrtarëve gjegjësisht të institucionit të punësimit; Kërkesën e ankueses të datës 11.07.2023 dhe 27.09.2023 përmes e-maileve zyrtare; Njoftimin e ankueses të datës 22.09.2023 përmes e-mailit zyrtar; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 23.10.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 30.10.2023 nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës dhe atë:





listën e vijueshmërisë së ankueses për hyrje daljet nga vendi i punës të datës 01.01.2023 deri më 23.10.2023; Kërkesën e ankueses me Nr.3783/23 të datës 10.07.2023 lidhur me aprovimin e pushimit mjekësor sipas dispozitave ligjore; Shkresën zyrtare lidhur me raportet e pushimit mjekësor të ankueses; Komunikimet elektronike të datës 31.05.2023, 28.05.2023, 01.06.2023, 02.06.2023, 01.06.2023, 20.06.2023, 19.05.2023, 11.04.2023, 06.04.2023, 02.04.2023, 04.04.2023, 20.06.2023, 11.04.2023, 06.04.2023, 17.07.2023, 14.07.2023, 13.07.2023, 14.07.2023, 21.07.2023, 18.07.2023, 28.07.2023, 21.07.2023, 18.09.2023, 05.09.2023, 14.07.2023, 05.09.2023, 13.07.2023 ndërmjet ankueses dhe zyrtarëve gjegjës të institucionit të punësimit; Raportin e punëtorëve për ankuesen që kanë munguar nga puna të datës 01.01.2023 deri më 05.09.2023 nga ministria në fjalë; Raportin e prezencës në punë për periudhën 01.01.2023 deri më 05.09.2023 për ankuesen; Komunikimet elektronike të datës 03.08.2023, 28.09.2023, 27.09.2023, 22.09.2023, 13.10.2023, 27.09.2023, 22.09.2023 ndërmjet ankueses dhe zyrtarëve gjegjës të institucionit të punësimit; Formularin e përshkrimit të punës për pozitën Udhëheqës i Sektorit të Monitorimit të Cilësisë së Ujërave dhe Dheut; Ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit të ankueses të datës 11.07.2017 së bashku me përshkrimin e detyrave të punës të datës 03.07.2017 për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Menaxhimin e Resurseve Ujore; Diplomën e ankueses me Nr.615 të datës 14.11.2007 nga Universiteti i Prishtinës-Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës si dhe komunikimet elektronike të datës 22.09.2023 ndërmjet ankueses dhe zyrtarëve gjegjës të institucionit në fjalë.

Kolegji i Këshillit, pasi ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës ka konstatuar që ankesa e ankueses , është e bazuar sepse:

Në funksion të shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimit të kundërshtuar me ankesë, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ( ligj ky i aplikueshëm në kohën e transferimit të ankueses) referuar procedurës së transferimit të përkohshëm të nëpunësve civilë, përkatësisht nenit 52 me të cilin përcaktohet se: "1. Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve; 1.2. për përmirësimin e rezultateve të vetë nëpunësit, deri në 3 muaj gjatë 2 vjetëve; 1.3. për arsye të përkohshme shëndetësore në bazë të vendimit të komisionit kompetent, sipas ligjit, për aq sa është e nevojshme, sipas vendimit të komisionit përkatës. 2. Transferimi mund të bëhet: 2.1. brenda institucionit ku është emëruar, duke përfshirë këtu edhe degët e tij lokale; 2.2. në një agjenci ekzekutive të institucionit ku është emëruar; 2.3. në një institucion tjetër të Shërbimit Civil. 3. Nëpunësi civil mund të refuzojë transferimin në këto raste: 3.1. kur gjendja e tij shëndetësore, provuar me vërtetim mjekësor, e bën transferimin të pamundur; 3.2. nëse vendi ku transferohet gjendet në shumë së 100 km nga vendbanimi i nëpunësit civil. 4. Nëpunësit civil, i cili transferohet në një vend tjetër pune me kërkesën e institucionit, në një lokacion tjetër, i cili është më i largët se sa vendi i tij i punës, i kompensohen shpenzimet e udhëtimit nga institucioni, i cili e transferon nëpunësin. 5. Nëpunësi civil, gjithashtu, mund të transferohet përkohësisht, për nevojat e institucionit apo shtetit, në një organizatë ndërkombëtare, në të cilën Republika e Kosovës është anëtare apo në një institucion ndërkombëtar. 6. Në përfundim të afatit të transferimit, nëpunësi civil kthehet në pozitën e mëparshme. 7. Qeveria, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për administratën publike, me akt nënligjor, miraton rregullat e hollësishme për transferimin e përkohshëm sipas këtij neni."

Po ashtu, Kolegji mori parasysh edhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, konkretisht të nenit 4 sipas të cilit është përcaktuar se: "1. Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës



kategori brenda dhe jashtë institucionit të administratës shtetërore dhe institucionit tjetër shtetëror sipas rasteve të përcaktuara në nenin 52. paragrafin 1 të Ligjit. 2. Transferimi i përkohshëm në rastet e parashikuara në Nenin 52, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Ligjit, nuk mund të bëhet për nëpunësit civilë në periudhën provë. 3. Në kuptim të Nenit 52. paragrafit 1, nën paragrafit 1.1 dhe 1.2 të Ligjit, në periudhën dy (2) vjeçare të viteve të punës nuk llogaritet koha e periudhës provuese. 4. Transferimi i përkohshëm bëhet me afat të përcaktuar në vendimin përkatës për transferim dhe është i detyrueshëm, përveç rasteve të parashikuara në Nenin 52. paragrafin 3 të Ligjit. 5. Pas përfundimit të afatit të transferimit të përkohshëm, nëpunësi civil kthehet në pozitën e mëparshme.", si dhe nenin 5 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, sipas të cilit është përcaktuar se: "1. Nëpunësi civil mund të transferohet në interes të institucionit me kërkesë të institucionit. Në rastet kur nëpunësi civil kërkohet të transferohet në një institucion tjetër të shërbimit civil, të ndryshëm nga institucioni ku ai është i emëruar, institucioni që paraqet kërkesën për transferimin e përkohshëm duhet të marrë paraprakisht miratimin e institucionit ku nëpunësi civil është i punësuar. 2. Transferimi i përkohshëm në interes të institucionit, miratohet nga njësia përgjegjëse, e cila njofton me shkrim nëpunësin civil që do të transferohet. Për marrjen e këtij vendimi njësia përgjegjëse mbështetet në analizën e plotësimit nga ana e nëpunësit të kritereve të pozitës të punës ku ai kërkohet të transferohet. 3. Nëpunësi civil gjithashtu mund të transferohet përkohësisht, për nevojat e institucionit apo shtetit, në një organizatë ndërkombëtare, në të cilën Republika e Kosovës është anëtare apo në një institucion ndërkombëtar".

Kolegji i Këshillit, pas analizimit të provave të lëndës si dhe ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankueses, ka konstatuar se bazuar në përshkrimin e detyrave të punës sipas pozitës të cilën e mban ankuesja me akt emërim del se pozita "Udhëheqës i Divizionit për Menaxhimin e Resurseve Ujore", në kuadër të Divizionit për Menaxhimin e Resurseve Ujore, tek fusha e përgatitjes profesionale të arsimit kërkohet: "*Diplomë universitare nga shkencat natyrore-fusha mjedisore, nga shkencat ekonomike dhe diplomë universitare ose ekuivalent me shkencat e hidrogjeologjisë, hidroteknikës*", ndërsa në pozitën si "Udhëheqës i Sektorit të Monitorimit të Cilësisë së Ujërave të Dheut", në kuadër të Sektorit për Monitorimin e Cilësisë së Ujit dhe Dheut, në të cilën ankuesja është sistemuar përkohësisht dhe është caktuar ti kryej punët dhe detyrat nga kjo pozitë bazuar në përshkrimin e detyrave të punës, tek fusha e përgatitjes profesionale të arsimit kërkohet: "*Diplomë/ a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve nga fusha e shkencave të Inxhinierisë dhe Shkencave të Natyrës*", e që në bazë të provave të lëndës të bashkangjitura nga organi i punësimit, ankuesja posedon Diplomën me Nr.615 të datës 14.11.2007 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, me të cilën dëshmohet se e njëjta me datën 29.12.2005 ka dhënë provimet e parapara dhe ka përfunduar Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës-Dega Ndërtimtari-Drejtimi Hidroteknik me ç' rast ka marrë titullin Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë. Ndërlidhur me këtë Kolegji vlerëson se për pozitën si "Udhëheqës i Sektorit të Monitorimit të Cilësisë së Ujërave të Dheut", në të cilën ankuesja është autorizuar lidhur me kryerjen e punëve dhe detyrave, nëpunësi duhet të jetë me kualifikim nga fusha e shkencave të inxhinierisë dhe shkencave të natyrës, e jo nga fusha e shkencave natyrore-fusha mjedisore, nga shkencat ekonomike dhe diplomë universitare ose ekuivalent me shkencat e hidrogjeologjisë, hidroteknikës dhe në këtë kuptim, realisht edhe nëpunësi i cili e ushtron këtë pozitë duhet të përmbaj edhe diplomën nga fushat e kërkua bazuar në përshkrimin e detyrave të punës sipas përshkrimit të lartcekur, andaj edhe pretendimi i ankueses ndërlidhur me këtë pjesë është i bazuar dhe ligjor.



Bazuar në këtë fakt, Kolegji i Këshillit, konstaton se përgatitja profesionale e ankueses nuk është e përshtatshme me përgatitjen profesionale respektivisht përshkrimin e detyrave të punës për pozitën të cilën është caktuar me transfer, andaj për rastin konkret të ankueses nuk është bërë analizë e saktë e plotësimit të kushteve lidhur me sistemimin e ankueses dhe autorizimin e kryerjes dhe detyrave për një pozitë tjetër për ankuesen, kështu që në këtë kontekst Kolegji vlerëson se Vendimi me Nr.5546/23 i datës 22.09.2023 i Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore, lidhur me sistemimin e ankueses për kryerjen e detyrave për pozitën në pozitën "Udhëheqëse e Sektorit të Monitorimit të Cilësisë së Ujërave dhe Dheut" është në kundërshtim me këtë frymë. Kolegji i Këshillit ndërlidhur me pretendimet ankimore tjera të ankueses, nuk është lëshuar fare meqenëse kontestuese në këtë procedurë nga ana e saj ka qenë ligjshmëria e Vendimit me Nr.5546/23 të datës 22.09.2023.

Andaj, bazuar në faktet si më lartë, e në vështrim të nenit 52 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, një akt administrativ i nxjerrë nga organi me shkelje të dispozitave procedurale dhe materiale është akt administrativ i paligjshëm, kështu që Këshilli me qëllim të vendosjes së ligjshmërisë, e duke u bazuar në autorizimet e përcaktuara me nenin 55 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka shfuqizuar Vendimin Nr.5546/23 të datës 22.09.2023 të Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, duke obliguar këtë të fundit që brenda afatit të përcaktuar si në pikën III të dispozitivit ta kthejë ankuesen në pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Menaxhimin e Resurseve Ujore", sipas Ndryshim Plotësimit të Akt Emërimit të datës 11.07.2017, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga marrëdhënia e saj e punës.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.


Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda, A.nr.1290/2023, datë 12/12/2023.

Ardita Perçuku-Shyti



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.